

Ushqimi dhe uji si parandaluesit më të mirë

Johanna Mandl BEd, LK NÖ; Fleckvieh Austria

Shumica e fermerëve, vetëm pasi lopët e tyre kanë kaluar një verë të gjatë dhe të nxehtë, kanë vërejtur se kushtet e mbajtjes së lopëve luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në performancën e tyre. Uji i mjaftueshëm me cilësi të mirë është një domosdoshmëri. Në varësi të performancës së tyre, lopët mund të konsumojnë mbi 180 litra ujë të freskët në ditë dhe kjo sasi duhet të jetë e disponueshme për to.



Shumë fermerë nuk i kushtojnë vëmendje vetëm sasisë së ujit që i nevojitet lopëve të tyre, por edhe cilësisë së ujit.

Përveç ushqimit me cilësi të lartë dhe të bazuar në performancë, furnizimi me ujë gjithashtu po merr gjithnjë e më shumë vëmendje. Shumë fermerë tani po shkojnë një hap më tej duke i kushtuar vëmendje jo vetëm sasisë së ujit që është në dispozicion të lopëve të tyre, por edhe çfarë uji është.

Kodi austriak mbi ujin e pijshëm nuk parashikon ndonjë kusht mbi cilësisë e ujit të pijshëm për kafshët shtëpiake dhe kafshët e fermave. Gjithashtu, rregullore të tjera i referohen vetëm "ujit të freskët" dhe jo specifikisht ujit të pijshëm, i cili është uji me cilësinë më të lartë. Sidoqoftë, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për fermerët, që kafshët e tyre të kenë ujë me cilësinë më të mirë të mundshme. Pse ndodh kjo?

Uji dhe ushqimi më i mirë

Furnizimi i lopëve, bazuar në nevojat e tyre me ujin më të mirë dhe ushqimin bazë është mënyra e vetme e qëndrueshme për të rritur lopë me performancë të lartë dhe jetëgjatësi në fermë. Ushqimet koncentrat dhe shtesat e ushqimeve minerale shërbejnë për të optimizuar lëndët ushqyese dhe minerale në racionin bazë dhe për t'i përshtatur ato me nevojat përkatëse, por ato në afat të gjatë nuk mund të kompensojnë as foragjeret, cilësinë e ujit, disponueshmërinë e ujit dhe higjenën e tij.

Analiza e ushqimit për kafshë sipas *metodës Weender*, pas 160 vjetësh nga zhvillimi i saj dhe pas disa përmirësimeve të nevojshme ndër vite është pranuar gjerësisht në praktikat bujqësore austriake. Fermerët e kontrollojnë ushqimin për përmbajtjen e lëndëve ushqyese dhe minerale. Laboratori i ushqimit Rosenau në Austrinë e Ulët, ofruet i shërbimit të pavarur për fermerët ofron të dhëna të besueshme dhe të verifikuara për llogaritjen e racionit. Ndërkohë, këto të dhëna transferohen automatikisht në programin e ushqimit RDV, për ta bërë më të lehtë trajtimin.

Analiza e cilësisë së ujit është e detyrueshme

Aushtu siç ndodh edhe me stresin nga nxehtësia ose me mastitin subklinik, cilësia dhe disponueshmëria e ujit vendosen në qendër të vëmendjes vetëm kur mangësitë bëhen shumë të dukshme. Për prodhimin e qumështit, minimalisht duhet të kërkohet kryerja rregullisht e analizave të cilësisë së ujit duke ekzaminuar pesë kritere biologjike, përfshirë E. coli dhe kontaminimin enterokoksik të ujit. Nëse sistemi i furnizimit me ujë është personal i juaji, këshillohet që të kontrolloni rregullisht cilësinë e ujit në pus dhe në çezëm. Kjo procedurë ndihmon për të zbuluar nëse uji në pus / në burim është i ndotur ose nëse "vetëm" sistemi i tubave është i vjetëruar ose i ndotur.

Analizat e ujit të pijshëm mund të kryehen pranë shërbimeve të laboratorëve. Këta laboratorë duhet të japin gjithashtu informacione mbi marrjen korrekte të mostrave dhe fushën e rekomanduar të analizës, ose duhet të jenë në gjendje të ofrojnë si hërbim marrjen e mostrave në vend. Në Austrinë e Poshtme, këtu duhet të përmendet Laboratori i Cilësisë i Austrisë së Ulët, i cili ka përvojë shumë vjeçare në punën me fermerë dhe zakonisht ofron ndihmë në interpretimin e të dhënave të analizës. Laboratori i Cilësisë i Austrisë ndodhet në St. Michael (Steiermark), Laboratori Rotholz (Tirol) dhe Laboratori Qendror Vorarlberg në Dornbirn janë kontakte të rëndësishme për pjesën tjetër të Austrisë.

Analiza e kampionit të ujit përveç përbërësve mikrobiologjikë, kimikë dhe fizikë të kampionit, përmban gjithashtu edhe treguesin përkatës dhe vlerat e parametrave (vlerat kufitare) sipas Kodit të Ujit të Pijshëm. Kjo e bën më të lehtë klasifikimin e cilësisë së ujit tuaj të analizuar.

Ndotja e fortë ose devijimet nga vlerat e treguesit dhe parametrave ose nga bakteret patogjene si E. Coli, ose nga ndotja kimike si nitratet ose metalet e rënda, mund të kenë një efekt negativ në mirëqenien e përgjithshme të lopëve duke e bërë tufën më të ndjeshme ndaj sëmundjeve. Edhe papastërtitë jo toksike mund të kenë një ndikim negativ në shijen e ujit, gjë që i bën lopët më pak të etura për ta konsumuar ose e konsumojnë ujin në sasi më të vogla.

Sasia duhet të jetë e duhura

Nëse cilësia e ujit është e duhura, atëherë në fermë duhet të sigurohet gjithashtu që sasia e ujit të korrespondojë me numrin e kafshëve. Gjatë viteve të fundit, reshjet e pakta ose përdorimi më intensiv i ujit fatkeqësisht janë bërë shkak që njëra ose tjetra fermë të kenë pasur probleme me furnizimin me ujë. Mund të supozohet se pasiguria në lidhje me shpërndarjen dhe frekuencën e reshjeve do të rritet. Prandaj është më mirë që fermat të punojnë me koncepte sot për të siguruar që kërkesat e ujit në fermën e tyre mund të sigurohen në planin afatgjatë. Lidhja me ujësjellësin lokal ose ndërtimi i rezervuarëve të ujit të shiut janë vetëm disa nga mënyrat që kompanitë mund të përdorin.

Nëse është e nevojshme përgatisni ujë

Nëse nuk mund të përjashtohet që cilësia e dobët e ujit të ketë një ndikim negativ në shëndetin e kafshëve, ose sepse lopët marrin shumë substanca potencialisht toksike ose thjesht duke mos pirë mjaftueshëm për shkak të mungesës së shijes, uji mund të trajtohet në mënyra të ndryshme. Ndotja bakteriologjike mund të bëhet e padëmshme me një dezinfektim ultraviolet relativisht të lirë dhe me mirëmbajtje të ulët.

Ngarkesat inorganike, dmth minerale në ujë (veçanërisht shumë gëlqere, shumë hekur, etj.) mund të ekuilibrohen me një shkëmbyes jonik. Kjo zbutje e ujit ka ofron avantazh edhe kur përdorni ujin në sistemin e mjeljes ose në familje, në mënyrë që depozitimet e gëlqeres të mos formohen shpejt.

Grazhdi dhe ena e ujit duhet të mbahen pastër

Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishmja, higjiena e grazhdeve dhe e pirëseve është thelbësore. Pirëset rekomandohet të pastrohen çdo ditë në mënyrë që të mos krijohen depozitime dhe grazhdi i ushqimit gjithashtu duhet të mbahet e pastër, dezinfektoheni atë në një mënyrë të tillë që të mbahet pastër lehtësisht. Në praktikë gjenden veshje me rrëshire epoksi, por edhe fletë dhe pllaka çeliku inox. Këto sipërfaqe të lëmuara dhe kryesisht rezistente ndaj konsumimit e bëjnë më të lehtë mbajtjen e grazhdit të ushqimit të pastër dhe të lëmuar, depozitime me erë të keqe nuk formohen aq shpejt. Mbi të gjitha, lopa është një kafshë që nuhat dhe duhet të jetë çdo ditë e lumtur kur “fut kokën” në racionin e ushqimit të freskët. Grazhdi dhe ena e ujit me erë të keqe veprojnë vetëm si një shtrëngues i panevojshëm i oreksit.

Ushqimi voluminoz i një cilësie të mirë nuk karakterizohen vetëm nga përbërës të mirë që mund të analizohen në laborator, por cilësia e tij mund të perceptohen edhe nga shqisat. Struktura dhe aroma e ushqimit voluminoz ndikojnë në sasinë që konsumohet dhe me sa dëshirë konsumohet nga lopët. Vlerësimi i ushqimit voluminoz, qoftë nëpërmjet shqisave apo dhe analitikisht në laborator janë pjesë e praktikës së mirë bujqësore. Kjo praktikohet gjithashtu nga fermat e prodhimit të qumështit në grupin e punës.

Skuadra e Austria Praemix shpk takohet për krahasimin vjetor të silazhit në vjeshtë për të parë vlerat e brendshme dhe të jashtme të ushqimit voluminoz, për të diskutuar me specialistë dhe për të shkëmbyer ide me kolegë profesionistë.



Austria Praemix shpk Team

Olger NANAGJOKA Menaxher i Shitjeve

Austria Praemix shpk
Adresa: Marikaj, Vorë
1051 Tirana, Albania

Tel.: +355 (0) 4 4813303 (Line 3)
Mob.: +355 (0) 68 40 26 311
E-Mail: agri@ap.com.al

Kristian MAKA Agjent Shitjesh – Shqipëri Veri

E-Mail: sales.n@ap.com.al
Mob.: +355 (0) 69 70 01 368

Dorian MILLONA Agjent Shitjesh – Shqipëri Lindje

Mob.: +355 (0) 69 60 80 850
E-Mail: sales.o@ap.com.al

Jon ZENELI Agjent Shitjesh – Shqipëri Jug

E-Mail: sales.s@ap.com.al
Mob.: +355 (0) 69 70 13 110

Rexhep PEPOSHI Agjent Shitjesh - Kosovë

Mob.: +355 (0) 69 70 93 795
E-Mail: kosova@ap.com.al